

Monitorimi i Prokurorisë së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm

RAPORT VLERËSIMI

Nr. 1

Mars 2025

Ky Raport Vlerësimi Nr. 1, për Eficiencën e Gjykatës dhe Cilësinë e Drejtësisë, është hartuar në kuadër të projektit “Konsolidimi i Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm – një Rishikim i Ndikimit mbi Eficiencën e Gjyqësorit dhe Cilësinë e Drejtësië” i zbatuar nga Instituti për Studimet Publike dhe Ligjore (ISPL), me mbështetjen e financimit të MATRA program i Mbretërisë së Hollandës, nëpërmjet përfaqësimit të saj në Shqipëri.

Projekti synon të përmirësojë eficiencën e performancës së Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Prokurorisë pranë saj pas shkrirjes së gjashtë gjykatave të apelit në një të vetme, në respektim të legjislacionit të miratuar për këtë qëllim dhe standarteve të cilësisë së drejtësisë.

© ISPL, Mars 2025

Riprodhimi është i autorizuar me kusht që të njihet e drejta e autorit.

ISPL nuk është përgjegjës për përdorimin që mund të bëhet i informacionit të mëposhtëm.

Tabela e Përmbajtjes

Tabela e Akromimeve.....	4
I. Hyrje	5
II. Eficenca në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm	6
II.1 Fillimi dhe përfundimi i ndjekjes penale në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit.....	6
II.2 Kategorizimi i çështjeve	7
II.3 Përfaqësimi i akuzës në fazën e gjyqësorit në GJA dhe rekursi në GJL	9
II.4 Dënimet alternative dhe komunikimi i vendimeve të GJA	10
II.5 Vendorsja e standardeve për kohëzgjatjen e procesit gjyqësor dhe ndikimi i hartës së re gjyqësore në efikasitetin e punës së PA	11
II.6 Trajtimi i vonesave në procedura	14
II.7 Përdorimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit	16
III. Cilësia në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.....	18
III.1 Vlerësimi i prokurorëve nga KLP	18
III.2 Standardet e vendimeve	20
III.3 Pranueshmëria e vendimeve	22
III.4 Zhvillimi profesional i prokurorëve dhe bashkëpunimi	24
IV. Përmbledhje Konkluzionesh dhe Rekomandime.....	26
Burimet	27

Tabela e Akromimeve

BE-	Bashkimi European
GJA-	Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm
GJL-	Gjykata e Lartë
ILD-	Inspektori i Lartë i Drejtësisë
KE-	Komisioni European
KEDNJ-	Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut
KLP-	Këshilli i Lartë i Prokurorisë
KP-	Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë
KPrP-	Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë
PA/Prokuroria pranë GJA-	Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm
PP-	Prokuroria e Përgjithshme
RSH-	Republika e Shqipërisë
SND-	Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë

I. Hyrje

Në shkurt 2023, Shqipëria iu nënshtrua një riorganizimi të rëndësishëm të hartës të saj gjyqësore, që u karakterizua ndër të tjera nga bashkimi i të gjitha gjykatave dhe prokurorive rajonale të Apelit në njësi të vetme me qendër në Tiranë. Ky ristrukturim synon të rishpërndajë ngarkesën e punës ndërmjet gjyqtarëve dhe prokurorëve, duke ndihmuar në optimizimin e burimeve njerëzore dhe financiare, rritjen e efikasitetit të gjykatave dhe zbutjen e ndikimit të procesit të vettingut. Ndërsa Shqipëria nis këtë kapitull të ri në organizimin e gjykatave dhe prokurorive, është e domosdoshme të monitorohet nga afër funksionimi dhe ndikimi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Ky raport shërben si një instrument vlerësimi në këtë moment të rëndësishëm, i cili fokusohet në mënyrë të veçantë tek efektiviteti dhe cilësia e drejtësisë së ofruar nga prokuroria pranë gjykatës së Apelit në këtë fazë të parë të punës së saj. Reformimi i thellë i gjyqësorit në Shqipëri nisi me reformën në drejtësi në vitin 2016, e cila reformoi kuadrin ligjor dhe institucional të gjyqësorit dhe shërbimeve të prokurorisë dhe vendosi garanci ligjore për të forcuar pavarësinë e gjyqësorit dhe prokurorisë.

Të kuptuarit e rëndësisë së *efektivitetit dhe cilësisë* në punën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit është parësore për disa arsye. Një prokurori e aftë dhe e përgjegjshme nuk është vetëm thelbësore për adresimin e kompleksitetit të çështjeve ligjore dhe garantimin e zbatimit të drejtë të ligjit, por është gjithashtu thelbësore në rivendosjen e besimit të publikut tek sistemi gjyqësor në përgjithësi. *Cilësia e drejtësisë* ndikon drejtpërdrejt në perceptimet e publikut për drejtësinë dhe llogaridhënien brenda sistemit gjyqësor, i cili shërben si një gur themeli për stabilitetin shoqëror dhe besimin në institucionet qeveritare. Për më tepër, *efektiviteti* i Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit ka implikime të rëndësishme për agjendën më të gjerë të reformës në drejtësi të Shqipërisë dhe aspiratat e saj për integrimin në Bashkimin Europian.

Ndërsa Shqipëria përpiqet të përafrojë standardet dhe praktikat e saj ligjore me ato të BE-së, aftësia e prokurorisë për të demonstruar profesionalizëm, transparencë dhe respektim të parimeve të shtetit të së drejtës do të jetë thelbësore në përmbushjen e kriterëve të përcaktuara nga Bashkimi Europian. Harta e re gjyqësore përballet ende me sfida, ndër të tjera lidhur me cilësinë dhe efikasitetin e drejtësisë. Problemet më akute lidhen më numrin të rasteve të pazgjidhura, kohëzgjatjen e procedimeve, mungesën e menaxhimit të integruar të çështjeve, aksesin e publikut, etj.

Në dritën e këtyre konsideratave, ky raport monitorimi do të vlerësojë efektivitetin operacional të Prokurorisë së sapo-organizuar të Apelit dhe cilësinë e ndjekjes penale që ajo realizon. Duke identifikuar pikat e forta dhe fushat për përmirësim brenda këtij institucioni kyç, raporti synon të ofrojë informacion dhe rekomandime që sugjerojnë përmirësime të mëtejshme.

Metodologjia e përdorur për hartimin e këtij raporti përfshin disa qasje: metodën sasiore të mbledhjes dhe organizimit të të dhënave të marra nga legjislacioni penal dhe procedural penal në fuqi, dokumente politikash, raportime të institucioneve pjesë të sistemit të prokurorisë etj.; si dhe metodën cilësore të vlerësimit dhe analizimit të të dhënave të mbledhura. Për secilën nga dy pjesët kryesore të këtij raportimi (Eficienca dhe Cilësia), analiza është parashikuar të ndahet në disa nën-kapituj, për çdo nën-komponent përbërës të efikasitetit dhe cilësisë. Për secilin prej nën-kapitujve, analiza tenton të japë përgjigje shteruese për pyetje teknike dhe substanciale, duke përfunduar me konkluzione specifike për secilin nën-kapitull. Disa nga burimet kryesore të të dhënave për hartimin e këtij raportimi janë raportet e vetë Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit fillestar, ato të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe ato të Prokurorisë së Përgjithshme. Vlerësimi i ka dhënë prioritet prioritet raporteve të fundit të këtyre institucioneve, që deri në fund të shkurtit 2025, janë

raportet për vitin 2023. Megjithatë, për aq sa ka qenë e mundur, janë bërë përpjekje për të siguruar të dhëna më të përditësuara nga Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit dhe KLP, lidhur me vitin 2024 dhe fillimin e 2025.

II. Eficenca në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm

Eficenca në Prokurorinë e Apelit është thelbësore për administrimin në kohë të drejtësisë në apel, veçanërisht pas rristurimit të rëndësishëm të hartës gjyqësore në Shqipëri në shkurt 2023. Një prokurori efikase e apelit jo vetëm që redukton diferencat e pazgjidhura dhe minimizon vonesat në procedurat ligjore, por gjithashtu duhet të kontribuojë që drejtësia në tërësi të jepet me shpejtësi, çka është thelbësore për ruajtjen e besimit të publikut në sistemin gjyqësor. Eficenca e përmirësuar mundëson zgjidhje më të shpejtë të ankesave, dhe njëkohësisht lehtëson volumnin e organeve të drejtësisë për të performuar shpejt dhe me cilësi. Secili nga nënkapitujt e mëposhtëm përfaqëson nga një element thelbësor për rritjen e efikasitetit në Prokurorinë e Apelit dhe përfundon me konkluzione specifike mbi aspektet pozitive aktuale dhe nevojat për ndërhyrje.

II.1 Fillimi dhe përfundimi i ndjekjes penale në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit

II.1.1 Cili është momenti procedural nga nisja e ndjekjes penale dhe një çështjeje nga ana e PA? Cili është momenti procedural pas të cilit përfundon detyra e PA?

Prokurorët e PA nisin ndjekjen e një çështjeje **pasi** është marrë vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë dhe është ankimuar në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm nga cilado prej palëve. PA njoftohet lidhur me këtë çështje, dhe afatet procedurale për të gjithë hapat që duhet të ndjekë prokurori nisin të llogariten nga momenti që shpallë prokurori i Prokurorisë së Apelit. Detyra e PA vazhdon me marrjen e **vendimit të Gjykatës së Apelit**, ose, në rast se cilado palë vendos për ushtrimin e të drejtës së rekursit, **me depozitimin e rekursit** në Gjykatën e Lartë.

Në përputhje me Nenin 24 të KPrP, disa nga detyrat e prokurorit (duke përfshirë edhe atë të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit) janë të ushtrimit ndjekjen penale dhe të përfaqësimit akuzën në gjyq në emër të shtetit, si dhe.... të marrë masa për **ekzekutimin e vendimeve penale** dhe të mbikëqyrë ekzekutimin e tyre. Prokurori pranë Gjykatës së Apelit përfaqëson akuzën në emër të shtetit në gjyq nga momenti që ajo ankimohej pranë Gjykatës së Apelit. Po ashtu, në përputhje me ligjin Nr. 79/2020 'Për ekzekutimin e vendimeve penale', prokurori është i detyruar të marrë të gjitha masat për ekzekutimin e vendimit penal në përputhje me urdhërimet e gjykatës dhe kërkesat e ligjit të mësipërm, si dhe të kontrollojë rregullsinë e ekzekutimit. Në rast të konstatimit të parregullsive, prokurori ka të drejtë t'i kërkojë organit përgjegjës ose gjykatës rivendosjen e të drejtës së shkelur, si dhe marrjen e masave ndaj personave përgjegjës.¹ Po ashtu, Rregullorja 'Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë'² parashikon që prokurorët e apelit marrin masa për zbatimin/urdhërimin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore me efekt të menjëhershëm sipas ligjit.³ Në këtë linjë, sipas raportit vjetor të Prokurorisë së Apelit për vitin 2023, ndjekja e ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës ka patur një prioritet, edhe për shkak të faktit se një pjesë e dënimeve të dhëna ishin në prag të përfundimit të tyre, dhe dërgimi i shkurtimeve të vendimeve që vihehin në dispozicion nga ana e trupave gjyqësore, mundësonte realizimin në kohë të urdhërave të ekzekutimit nga ana e zyrave përkatëse në Prokuroritë e Rretheve.⁴

II.1.2 A e ndjek prokurori/prokuroria kohëzgjatjen e çështjes nga fillimi deri në përfundimin e ndjekjes penale, edhe nëse një çështje i kalon një prokurori tjetër me juridiksion të ndryshëm material?

Jo, prokurori i mëparshëm nuk vazhdon ndjekjen e çështjes në asnjë aspekt, përfshirë edhe elementet e kohëzgjatjes së çështjes. Ky rregull aplikohet jo vetëm në momentin kur një çështje i kalon një prokurorie me

¹ Neni 8 i Ligjit Nr. 79/2020 'Për ekzekutimin e vendimeve penale'.

² Shënim: kKo rregullore daton para reformimit të hartës gjyqësore në Shqipëri.

³ Rregullorja 'Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë' datë 26.04.2021, Neni 11(2)(c).

⁴ Raporti Vjetor mbi ecurinë e punës në Prokurorinë e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për vitin 2023, faqe 6.

juridiksion të ndryshëm material, por edhe brenda Prokurorisë së Apelit, kur një çështje i kalon një prokurori tjetër, brenda së njëjtës prokurori.

II.1.3 A cakton prokurori një numër unik të çështjes nga akti fillestar (çështja e paraqitur në prokurori për herë të parë) deri në vendimin përfundimtar të gjykatës, përfshirë procedurat e ekzekutimit?

Nuk ka ende një numër unik për dosje. Dosja regjistrohet me një numër të caktuar pranë Prokurorisë së Shkallës së Parë, me një numër të ndryshëm në rastin kur i referohet Gjykatës së Shkallës së Parë, dhe me numër të ndryshëm në PA dhe GJA, i cili përcaktohet nga numri rendor në regjistrat përkatës të secilit institucion.

Caktimi i një numri unik të dosjes ose çështjes, i cili nuk ndryshon me kalimin e saj nga një prokurori apo gjykatë është i rëndësishëm për shumë arsye. Një numër çështjeje i pandryshueshëm ofron mundësinë e identifikimit të lehtë të dosjes dhe mundëson ndjekjen efikase të çështjes ndërsa përparon përmes sistemit ligjor. Të gjitha dokumentet, provat dhe të dhënat në lidhje me atë rast mund të organizohen dhe menaxhohen nën një numër unik dhe identifikues. Ky numër lehtëson komunikimin dhe bashkëpunimin pa vonasa mes institucioneve të drejtësisë, si dhe shmang gjasat e gabimeve. Po ashtu, gjurmimi i rasteve nga ana e secilit prej institucioneve që e ka ndjekur, bëhet shumë më i lehtë nëse numri i dosjes nuk ndryshon nga një institucion tek tjetri.

Konkluzione lidhur me fillimin dhe përfundimin e ndjekjes penale në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit

Kodi i Procedurës Penale përmban **parashikime të qarta lidhur me kohëzgjatjen** e secilit hap procedural gjatë përfaqësimit të akuzës në GJA. Në nivel parashikimesh ligjore procedurale, legjislacioni shqiptar vlerësohet se përmban garancitë e nevojshme për të inkurajuar një procedim të shpejtë. Detyra e prokurorit të PA dhe rrjedhimisht edhe përgjegjësia për respektimin e afateve procedurale **nis me shortimin** e prokurorit që do të përfaqësojë akuzën pranë Gjykatës së Apelit (GJA), dhe përfundon me marrjen e **formës së prerë të vendimit ose rekursin** ndaj këtij vendimi në GJL, si dhe me ekzekutimin e vendimit. Puna e një prokurori mbetet individuale për sa kohë prokurori është caktuar për të ndjekur një çështje, pa patur mundësinë të ndjekë përfundimin e ndjekjes penale në rastet kur çështjet i kalojnë një prokurorie të një juridiksioni tjetër apo qoftë edhe një prokurori tjetër brenda PA. Një problematikë për t'u adresuar është **mungesa e një numri unik** të dosjeve, çka mund të ndikojë në ngadalësimin e bashkëpunimit midis institucioneve të drejtësisë dhe rritjen e mundësive të gabimeve.

II.2 Kategorizimi i çështjeve

II.2.1 A ka një kategorizim të çështjeve sipas natyrës, kompleksitetit apo kohëzgjatjes së tyre?

Kategorizimi i çështjeve realizohet **para se ajo të bëhet pjesë e një juridiksioni të një gjykate** të caktuar. Për shembull, ndjekja penale dhe hetimi i veprave penale të korrupsionit, krimit të organizuar dhe çështjeve penale të lidhura me funksionarë të lartë realizohet nga prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK).⁵ Në momentin që çështja bën pjesë në juridiksionin e prokurorisë së juridiksionit të përgjithshëm, nuk ka parashikime ligjore lidhur me një kategorizim të brendshëm të ri brenda një prokurorie. Në parim, çdo çështje e cila ankimohet pranë GJA nga cilado prej palëve, nëpërmjet shortit i kalon një prej prokurorëve të apelit për të përfaqësuar akuzën.

Megjithatë, pavarësisht se nuk përdoret termi 'kategorizim', vetë legjislacioni procedural penal si dhe praktika në Prokurorinë e Apelit parashikon një ndarje fillestare të çështjeve në: masat e sigurimit personal dhe çështje themeli, duke marrë parasysh kriterin e urgjencës.

⁵ Neni 135(2) i Kushtetutës së RSH.

Për më tepër, Raporti Vjetor i PA për vitin 2023 shprehet se, për çështjet e themelit, nga ana e drejtuesit të prokurorisë është treguar kujdes që **trajtimi e ndarja e çështjeve midis prokurorëve të jetë e barabartë**, jo vetëm duke u nisur nga numri, por edhe nga:

- shkalla e rrezikshmërisë dhe e rëndësisë së çështjes;
- numri i të pandehurve;
- çështjet që gjykohen në apel mbi bazën e ankimeve të prokurorëve apo ankimeve të bëra nga ana e palëve të tjera në procesin penal.⁶

Sa më sipër, jemi para zbatimit në praktikë të një mënyre kategorizimi të çështjeve brenda PA, me qëllim shpërndarjen më të balancuar të ngarkesës. Megjithatë, rregullat e këtij 'kategorizimi' të çështjeve nuk janë ende të qarta, duke mos qenë të saknionuara në një akt normativ apo të brendshëm të PA.

II.2.2 A përdor shërbimi i prokurorisë ndonjë formë të metodologjisë së "case weighting" për të vlerësuar kompleksitetin e rasteve?

Jo. Pavarësisht përpjekjeve për të realizuar një shpërndarje sa më të balancuar të çështjeve midis prokurorëve, teknika e 'case weighting' është specifike, vendoset nga vetë institucioni nëpërmjet rregulloreje apo një akti të ngjashëm dhe përdor indekse dhe pikëzim për indkatorë të ndryshëm për secilën çështje, duke konsideruar (*inter alia*):

- nëse është pranuar akuza apo jo nga i pandehuri;
- nëse ka nevojë për ekspertizë të re;
- nëse çështje të ngjashme zgjidhen për një kohë të shkurtër ose të gjatë;
- nëse ka një numër të lartë dëshmitarësh dhe/ose viktimash;
- nëse çështja ka karakter kombëtar apo ndërkombëtar;
- nëse ka nevojë për përkthim, etj.⁸

Deri tani nuk ka një rregullore të posaçme për *case weighting* dhe në ndarjen e çështjeve midis prokurorëve ende nuk përdoret tekika e pikëzimit të çështjeve.

II.2.3 A përdor shërbimi i prokurorisë teknologjinë e informacionit dhe komunikimit (TIK) për të zbatuar kategorizimin e çështjeve apo metodologjinë e "case weighting"?

Jo. Si do të trajtohet edhe më poshtë, PA dhe shërbimi i prokurorisë së juridiksionit të përgjithshëm në tërësi ende nuk përdor në mënyrë funksionale sisteme digjitale të menaxhimit të çështjeve.

Konkluzione për kategorizimin e çështjeve dhe 'case weighting'

Kategorizimi i çështjeve dhe 'case weighting' janë aspekte të rëndësishme të menaxhimit efektiv të ndjekjes penale, në drejtim të ndarjes së burimeve në mënyrë më efektive, menaxhimit më të mirë të kohës dhe planifikimit strategjik. Vetë legjislacioni procedural penal tenton të 'kategorizojë' çështje duke parashikuar afate me të shkurtra, për shembull për procedurat e masave të sigurimit, procedurat kur i pandehuri është në paraburgim⁹, etj. Megjithatë, një formë më e detajuar dhe specifike në kuadër të rritjes së efikasitetit në

⁶ Raporti Vjetor mbi ecurinë e punës në Prokurorinë e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për vitin 2023, faqe 22.

⁷ Termi 'case weighting' (peshimi i çështjeve) i referohet një mekanizmi që përdoret për të vlerësuar natyrën dhe kompleksitetin e një çështje/procedure. Mënyra më e zakonshme për të vlerësuar ngarkesën e një çështjeje të caktuar është duke përdorur të njëjtën njësi dhe kalibrim për të vlerësuar të gjitha çështjet në shqyrtim, edhe nëse çdo çështje ka kompleksitetin e vet (burimi: Këshilli i Europës, <https://rm.coe.int/cepej-saturn-2017-7erev10e-case-weighting/16808ccb22#:~:text=The%20weighting%20of%20cases%20is,case%20has%20its%20own%20complexity.>).

⁸ Council of Europe, CEPEJ, Case Weighting in European Justice Systems, 2018, https://rm.coe.int/cepej-saturn-2017-7erev10e-case-weighting/16808ccb22#_Toc510802389

⁹ Për shembull, afatet e parashikuara në Nenin 263 të KPrP.

menaxhimin e çështjeve është 'case weighting', e cila bazohet në indikatorë dhe një sistem pikëzimi. 'Case weighting' ende nuk aplikohet në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit.

II.3 Përfaqësimi i akuzës në fazën e gjykimit në GJA dhe rekursi në GJL

II.3.1 Cila prokurori ka kompetencën për të vendosur për ankim në GJA? Po rekurs në GJL?

Kompetencën për të ankimuar vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë e ka **prokuroria përkatëse pranë gjykatës së shkallës së parë** të juridiksionit të përgjithshëm¹⁰ ose palët e tjera në gjykim. Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit angazhohet në momentin që çështja është ankimuar pranë GJA (qoftë nga ana e ndjekjes penale në shkallë të parë, të pandehurit, apo paditësit dhe të paditurit civil).¹¹

Rekursi në GJL mund të realizohet nga **prokurori që ka përfaqësuar akuzën pranë GJA** ose nga palët e tjera në proces.

II.3.2 A mbledh prokurori të dhëna për kohëzgjatjen e përsëritjes së shqyrtimit gjyqësor gjatë fazës së gjykimit në GJA?

Po. Prokurori i cili përfaqëson akuzën në GJA informohet gjatë seancës gjyqësore lidhur me vendimin e GJA (të marrë kryesisht apo me kërkesë të palëve) për përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor. Lidhur me përsëritjen e shqyrtimit të vendosur nga GJA, procedohet menjëherë dhe kur kjo nuk është e mundur, shqyrtimi gjyqësor shtyhet për një afat jo më të gjatë se dhjetë ditë.¹²

II.3.3 A e përfaqëson prokurori gjithmonë akuzën në gjykatë?

Po, në sistemin gjyqësor shqiptar në tërësi, **i vetmi funksionar** i cili ka kompetencën të ushtrojë ndjekjen penale dhe të përfaqësojë akuzën në gjyq në emër të shtetit është **prokurori**.¹³ Delegimi dhe marrja përsipër e funksioneve të prokurorit nga autoritete të tjera janë të ndaluara.¹⁴ Ky parim vlen edhe në rastin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, ku prokurori është i vetmi funksionar i cili mund të përfaqësojë akuzën në GJA.

II.3.4 A mbledh prokurori të dhëna për datën e seancave të palëve dhe pjesëmarrësve të tjerë në procedurë (p.sh. viktimave dhe dëshmitarëve). A mbledhen të dhëna të tilla edhe në raste shumë komplekse që përfshijnë ndërhyrjen e shumë individëve?

Po, por këto janë të dhëna të cilat administrohen nga Gjykata e Juridiksionit të Përgjithshëm të Apelit, jo nga prokurori në mënyrë të pavarur.

II.3.5 A janë të disponueshme të dhënat për kohëzgjatjen e hapave të ndryshëm proceduralë për palët e procesit ose përfaqësuesit e tyre? Po për publikun?

Po. Këto të dhëna janë publike pasi parashikohen nga KPrP.

II.3.6 A ka një përlllogaritje të kohës së pritshme apo maksimale, të përcaktuar me ligj, rregulla procedurale apo udhëzime të brendshme për prokurorinë, që nevojitet për të kryer hapa të veçantë proceduralë?

Po, KPrP parashikon afatet për hapat e veçantë proceduralë. Për shembull, pala që nuk ka bërë ankim (pranë gjykatës së Apelit) brenda afatit mund të bëjë apel kundërshtues brenda pesë ditëve nga dita kur ka marrë njoftimin për apelin e palës tjetër¹⁵; kur një palë në aktin e apelit kërkon rimarrjen e provave të lejuara në shqyrtimin gjyqësor të shkallës së parë ose marrjen e provave të reja dhe gjykata e Apelit pranon, shqyrtimi

¹⁰ KPrP, Neni 408.

¹¹ KPrP, Neni 422.

¹² KPrP, Neni 427(5).

¹³ KPrP, Neni 24(1).

¹⁴ Ligji Nr. 97/2026 'Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë', Neni 11(2) dhe (3).

¹⁵ Neni 423 i KPrP.

gjyqësor shtyhet për një afat jo më të gjatë se dhjetë ditë¹⁶; Rekursi në Gjykatën e Lartë duhet të paraqitet me shkrim brenda 45 ditëve nga e nesërmja e shpalljes së vendimit të Gjykatës së Apelit¹⁷, etj.

Lidhur me respektimin e afateve të parashikuar në KPrP, Rregullorja 'Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë Pranë Gjykatës së Apelit Tiranë' (e cila vazhdon të jetë në fuqi edhe pas ndryshimit të hartës gjyqësore), parashikon që prokurorët e apelit duhet të marrin të gjitha masat dhe të planifikojnë në mënyrë sa më efikase veprimet e duhura procedurale **pa shkaktuar ndërprerje dhe zvarritje të panevojshme** seancave të gjykimit në apel, me qëllim përfundimin e çështjes brenda afateve të përcaktuara në KPrP.¹⁸

Konkluzione për përfaqësimin e akuzës në fazën e gjykimit në GJA dhe rekursin në GJL

Në sistemin e drejtësisë në Shqipëri, prokurori ka kompetenca të rëndësishme dhe ekskluzive të ndjekjes penale dhe përfaqësimit të akuzës në gjykatë. Megjithëse vendimmarrja për ankimimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë merret nga prokurori pranë gjykatës së shkallës së parë, përfaqësimi i akuzës pranë GJA realizohet nga tjetër prokuror, pikërisht një prej prokurorëve të PA. I njëjti parim zbatohet edhe për ushtrimin e të drejtës së rekursit (nga prokurori pranë GJA) dhe përfaqësimi i akuzës në GJL (nga prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme). Afatet procedurale të gjykimit në GJA përcaktohen nga KPrP, dhe administrohen nga gjykata, e cila informon palët pjesëmarrëse, përfshirë prokurorin. I njëjti parim vlen edhe në rast se gjykata vendos përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor në nivel apeli. Në çdo rast, në përputhje edhe me rregulloren e GJA, prokurori ka për detyrë të shmangë çdo vonesë apo zvarritje të procesit.

II.4 Dënimet alternative dhe komunikimi i vendimeve të GJA

II.4.1 A ka një procedurë për pranimin e fajësisë?

Procedura për pranimin e fajësisë i shërben efikasitetit të punës së prokurorisë duke qenë se shkurton kohën dhe burimet e shumta që përdoren në funksion të hetimit penal. Sipas Nenit 25 të KPrP, prokurori mund të arrijë një marrëveshje mbi kushtet për pranimin e fajësisë dhe caktimin e dënimit. Nga çasti i regjistrimit të emrit të personit që i atribuohet vepra penale derisa të **mos ketë filluar shqyrtimi gjyqësor**, prokurori, i pandehuri, ose përfaqësuesi i tij i posaçëm mund të propozojnë arritjen e një marrëveshjeje mbi kushtet për pranimin e fajësisë dhe për caktimin e dënimit.¹⁹ Megjithatë, kjo është një kompetencë që i takon prokurorit të prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, dhe jo Prokurorit të Apelit. Ashtu si u përmend më lart, puna e prokurorëve të apelit nis në momentin kur vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë ankimohet në GJA, pra, përtej momentit procedural kur mund të arrihet marrëveshja e pranimit të fajësisë.

II.4.2 Nëse po, a përfshin kjo procedurë një gjyqtar dhe brenda çfarë afati kohor?

Kjo është një procedurë e cila realizohet midis prokurorit dhe të pandehurit apo përfaqësuesit të tij ligjor.

II.4.3 Ka prokurori kompetencën për të vendosur për dënimet alternative? Po policia gjyqësore?

Procedura e caktimit të dënimeve alternative **drejtohet nga gjykata**, dhe roli i prokurorit në këtë procedurë është të vendosë nëse do të kërkojë revokimin e këtij dënimi, pasi është dhënë nga gjykata. Sipas Nenit 53/a të KP, GJykata, në rastet kur parashikohet shprehimisht nga dispozita, kur çmon që vepra penale dhe autori i saj paraqesin rrezikshmëri të ulët shoqërore dhe kur cakton një dënim deri në dy vjet burgim, mund të vendosë zëvendësimin e dënimit me burgim me pagimin e një shume të hollash në favor të shtetit.

Sipas Kreut VII të KP (Alternativat e dënimit me burgim), është gjykata ajo që vendos lidhur me zëvendësimin e dënimit me burgim me dënime të tjera alternative, si gjysëmliria (Neni 58); pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë (Neni 59); qëndrimi në shtëpi (Neni 59/a); etj. Megjithatë, zbatimi i

¹⁶ Neni 427 i KPrP.

¹⁷ Neni 435 i KPrP.

¹⁸ Rregullorja 'Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë Pranë Gjykatës së Apelit Tiranë', Neni 12.

¹⁹ Neni 406/d i KPrP.

dënimeve alternative ka hasur vështirësi. Sipas Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë (SND) 2024-2030, vonesat në ekzekutimin e vendimeve me shërbim prove ndikojnë negativisht në zbatimin e dënimit alternativ, reduktojnë efektin individual të tij dhe dëmtojnë besimin në sistemin e drejtësisë.²⁰

Vendimi për zbatimin e procedurave alternative ndaj ndjekjes penale nuk mund të vendoset nga stafi në varësi të autoriteteve të prokurorisë, si Policia Gjyqësore. Sipas Ligjit Nr. 25/2019 'Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore', ka raste të veçanta kur oficerët e Policisë Gjyqësore veprojnë me iniciativën e tyre, por me kushtin që të lindë nevoja e ruajtjes së gjurmës së veprës penale ose e vendngjarjes.²¹ Gjithashtu, Policia Gjyqësore zbaton urdhërat dhe udhëzimet e prokurorit për përcaktimin e çështjeve që duhen hetuar me përparësi, e veprimeve konkrete që duhen kryer, si dhe për kohëzgjatjen e nevojshme të hetimeve.²² Po ashtu, sipas ligjit 97/2026 'Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë', funksionet e prokurorisë ushtrohen vetëm nga prokurorët e Republikës së Shqipërisë, të emëruar sipas ligjit.²³

II.4.4 Kur merr njoftim prokuroria kur një vendim merr formë të prerë? Në çfarë forme?

Pranë PA funksionojnë **dy regjistra të posaçëm**, ku në njërin pasqyrohet saktësisht data e depozitimit të vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me qëllim përllogaritjen e saktë të afatit të rekursit dhe në tjetrin, momenti i depozitimit të rekursit të palëve, me qëllim realizimin e kundër rekursit kur shihet e nevojshme nga ana e prokurorëve.²⁴

Pasi GJA merr vendimin e saj, **dispozitivi i vendimit** i komunikohet prokurorit të apelit **brenda ditës** nga Gjykata. **Vendimi i arsyetuar** i vihet në dispozicion Prokurorisë së Apelit në një datë më të vonë, dhe depozitohet pranë kësaj prokurorie nga stafi i gjykatës. Vendimi i arsyetuar (pa zbardhjen e të cilit nuk është e mundur të realizohet rekurs) shpesh, për shkak të ngarkesës së Gjykatës së Apelit, karakterizohet nga **vonesa të konsiderueshme**. Këto vonesa shtynjë afatin procedural për rekurs, duke shkaktuar zvarritje të procedurave dhe dobësuar efektivitetin.

Konkluzione për dënimet alternative dhe komunikimet e vendimeve të GJA

Vendimmarrja për dënimet alternative ka potencialin të përmirësojë efikasitetin e sistemit të drejtësisë penale duke ulur kostot, promovuar rehabilitimin e autorëve të veprave penale dhe duke bërë të mundur një përgjigje më humane dhe efektive ndaj sjelljeve kriminale. Megjithatë, suksesi i përdorimit të dënimeve alternative varet nga zbatimi i mirëmenduar dhe i kujdesshëm i rregullave të parashikuara në legjislacionin penal dhe atë procedural penal. Caktimi i dënimeve alternative drejtohet nga gjykata, ndërsa prokurori mund të bëjë propozime për ndryshime. Policia gjyqësore nuk ka kompetenca lidhur me caktimin apo kundërshtimin e dënimeve alternative.

Lidhur me komunikimin e vendimeve të GJA, praktika ka hasur në vështirësi. Pavarësisht se dispozitivi i vendimit bëhet i njohur në seancën e fundit gjyqësore dhe një vendim i shkurtuar i vihet në dispozicion prokurorisë në rastet e emergjencës, vendimi i arsyetuar shpesh kalon kufijtë kohorë të zbardhjes, duke vonuar ushtrimin e të drejtës së rekursit nga secila prej palëve të legjitimuar.

II.5 Vendorsja e standardeve për kohëzgjatjen e procesit gjyqësor dhe ndikimi i hartës së re gjyqësore në efikasitetin e punës së PA

II.5.1 A ka ndonjë kornizë kohore/standarde të përcaktuar me ligj, rregulla procedurale ose udhëzime të brendshme të prokurorisë që përcaktojnë kohëzgjatjen e procedurave?

²⁰ SND 2024-2030, faqe 45-46.

²¹ Neni 6 i Ligjit Nr. 25/2019 'Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore'.

²² Neni 7(2) i Ligjit Nr. 25/2019 'Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore'.

²³ Neni 11 i Ligjit 97/2026 'Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë'.

²⁴ Raporti Vjetor mbi ecurinë e punës në Prokurorinë e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për vitin 2023

Për secilën nga fazat e procedimit penal, KPrP parashikon **afatet maksimale** brenda të cilave duhet të realizohen. Megjithatë, këto afate nuk lidhen posaçërisht me punën e Prokurorisë së Apelit, por me procesin gjyqësor në Gjykatën e Apelit në përgjithësi. Lidhur me këtë detyrim, Rregullorja 'Per organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë' parashikon që prokurorët e apelit duhet të marrin të gjitha masat dhe të planifikojnë në mënyrë sa më efikase veprimet e duhura procedurale pa shkaktuar ndërprerje dhe zvarritje të panevojshme seancave të gjykimit në apel, me qëllim përfundimin e çështjes brenda afateve të përcaktuara në KPrP.²⁵ Megjithatë, në kushtet që prokuroria pranë Gjykatës së Apelit po funksionon me një numër të limituar prokurorësh, **përplasjet** midis datave dhe orareve të seancave gjyqësore të ndjekura nga i njëjti prokuror shpesh janë të paevitueshme.

II.5.2 A ekziston një mekanizëm që prokurori/shërbimi i prokurorisë të monitorojë ekzekutimin dhe kohëzgjatjen e procedurave të sanksioneve dhe zgjidhjes?

Ende **nuk ka një mekanizëm efikas** për monitorimin e ekzekutimit të procedurave të sanksioneve. Lidhur me këtë problem SND 2024-2030 parashikon në Planin e saj të Veprimit si masë më vete hartimin e analizave, duke përfshirë një plan (nga secili institucion), për ekzekutimin në kohë dhe në mënyrë efikase të vendimeve gjyqësore, identifikimin e arsyeve të vonesave dhe sugjerimin e masave korrigjuese.²⁶

II.5.3 A janë përdoruesit dhe publiku i gjerë të informuar për kohëzgjatjen e pritshme të procedurës penale?

Përveç parashikimeve të kohëzgjatjes së procedurave të përcaktuara me ligj, secila prokurori dhe gjykatë ka në përbërje respektivisht **prokurorin e medias dhe gjyqtarin e medias**, të cilët kanë në funksion dhe mbajtjen e komunikimeve në emët të prokurorisë apo gjykatës ku ushtrojnë detyrën me median dhe publikun.

Dhënia e informacionit për publikun nga prokuroria pranë gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm i nënshtrohet rregullave të përcaktuara nga Udhëzimi i Përgjithshëm i PP Nr. 05 datë 30.07.2019 'Për marrëdhëniet me publikun në Prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm'. Ky akt detajon mënyrën e informimit të publikut dhe medias, bazuar në parimin e **balancimit të interesave**, midis të drejtës së publikut për informim dhe parimin e mbrojtjes së hetimit, ndjekjes penale dhe sigurisë juridike.²⁷ Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit në faqen zyrtare të internetit i dedikon një rubrikë Programit të Transparencës,²⁸ nga ku publiku mund të informohet lidhur me kuadrin rregullator, të drejtën për t'u informua dhe ankuar, regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve, njoftime, publikime, etj. Megjithatë, aktualisht faqja zyrtare e internetit të PA nuk jep detaje lidhur me të dhënat e prokurorit të medias pranë kësaj prokurorie.

II.5.4 Si ka ndikuar harta e re gjyqësore në garantimin e standardeve që lidhen me efikencën e Prokurorisë së Apelit?

Nga data 01.02.2023, harta e re gjyqësore filloi të aplikohet duke sjellë ndryshime të rëndësishme, ndër të tjera ndërprerjen e veprimtarisë dhe pushimin se ekzistuari të Prokurorive pranë Gjykatave të Apelit Shkodër, Durrës, Korçë, Vlorë, Gjirokastrë në datën 31.1.2023. Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Tiranë (e riemërtuar me Urdhërin Nr.9, datë 18.1.2023) vazhdoi funksionimin pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, me kompetenca tokësore në gjithë territorin e vendit.

Centralizimi i prokurorisë së apelit në një institucion të vetëm në Tiranë, ka potencialin të përmirësojë efikencën e punës në prokurorinë e apelit, si standardizimi i procedurave dhe qasjeve, çka mund të kontribuojë në kohë më të shpejtë të procedimit dhe rritje të cilësisë; shfrytëzimin më efektiv të burimeve njerëzore dhe materiale; përmirësimin e komunikimit dhe bashkëpunimit mes prokurorëve; lehtësi në procesin e përpunimit

²⁵ Rregullorja 'Per organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë' datë 26.04.2021, Neni 12.

²⁶ SND 2024-2030, faqe 95.


²⁷ Udhëzimi i Përgjithshëm i PP Nr. 05 datë 30.07.2019 'Për marrëdhëniet me publikun në Prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm', Neni 5.

²⁸ https://www.pp.gov.al/Prokuroria_e_Apelit_Tirane/Programi_i_Transparences_17056/

të të dhënave; specializimin e mëtejshëm të prokurorëve; etj. Megjithatë, arritja e këtyre objektivave duhet të shoqërohet me garanci dhe mjete të përshtatshme.

Lidhur me ndryshimin e hartës gjyqësore, PP miratoi Udhëzimin e Përgjithshëm Nr. 01 datë 26.01.2023 'Për masat administrative dhe procedurale për zbatimin e hartës së re gjyqësore në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë dhe gjykatës së apelit të juridiksionit të përgjithshëm'. Ky udhëzim i përgjithshëm përcakton ndër të tjera nevojën për marrjen e masave të duhura procedurale penale për zbatimin e parimit të procesit të rregullt ligjor, në garantimin e lirive dhe të drejtave të personave me masë sigurimi personal, personave nën hetim, të pandehurve dhe/ose viktimave të procedimit penal gjatë periudhës dhe/ose procedurës së mbartjes së akteve, procedimeve apo çështjeve në prokuroritë kompetente sipas ligjit dhe normimeve të këtij udhëzimi të përgjithshëm.²⁹ Në lidhje me ecurinë e **mbartjes së akteve procedurale dhe administrative**, në përputhje me udhëzimin, raporti i Prokurorisë së Apelit për vitin 2023 konfirmon se ky proces u realizua dhe **përfundoi në kohë**, si për sa i përket akteve procedurale, pra akteve që përmbanin çështjet penale të arkivuara dhe ato të mbartura në shqyrtim gjyqësor, ashtu dhe ato administrative, **pa hasur problematika**. Po ashtu, i njëjti raport shprehet se në asnjë rast nuk pati problematika në lidhje me përfaqësimin në gjykim të çështjeve të mbartuara më parë nga ish Prokuroritë e Apeleve.³⁰

Megjithatë, **volumi i punës** është rritur ndjeshëm me përqendrimin e organit të akuzës në nivel apeli në një institucion të vetëm. Pavarësisht kësaj, kjo prokurori vepron ende me një **numër të reduktuar prokurorësh**, i cili në fund të vitit 2023 ishte vetëm nëntë të tillë³¹ nga 26 pozicione prokurorësh të parashikuar në organigramë, miratuar me vendim të PP. Ndërsa për masat e sigurimit është përdorur sistemi i prokurorëve të gatshëm (tre të tillë në javë). Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit konfirmon se deri në shkurt 2025 numri i prokurorëve faktikë në këtë prokurori është dhjetë (nëntë të përhershëm dhe një i komanduar), nga njëzet pozicione prokurorësh të parashikuar në organigramën e ndryshuar, ashtu si pasqyrohet më poshtë:



Burimi: Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm

Numri aktual i prokurorëve të apelit **është shumë i vogël në krahasim me nevojat** e parashikuara në organigramën e institucionit. Duke qenë e vetmja prokurori apeli në vend, prokuroria e ka të domosdoshme plotësimin e vakancave në pozicionin e prokurorit, për të lehtësuar ngarkesën e punës së prokurorëve faktikë dhe rritur eficientë në punën e prokurorisë së apelit. Sipas të dhënave nga KLP, aktualisht³² janë hapur 3

²⁹ Udhëzimin e Përgjithshëm Nr. 01 datë 26.01.2023 'Për masat administrative dhe procedurale për zbatimin e hartës së re gjyqësore në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë dhe gjykatës së apelit të juridiksionit të përgjithshëm', Neni 10.

³⁰ Raporti Vjetor mbi ecurinë e punës në Prokurorinë e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për vitin 2023, faqe 2.

³¹ Raporti Vjetor mbi ecurinë e punës në Prokurorinë e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për vitin 2023, faqe 2.

³² Shkurt 2025.

vakanca për pozicione të përhershme në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit nga ana e KLP-së, i cili do të realizojë analizën e aplikimeve në raport me kriteret ligjore.

Gjatë vitit kalendarik 2023, numri i çështjeve ishte si vijon:

- Numri i çështjeve të mbartura nga bashkimi i prokurorive të apelit: 9845
- Numri i çështjeve të reja të natyrës penale të regjistruara: 6654
- Numri i çështjeve penale të kthyer për rigjykim nga Gjykata e Lartë (GJL): 118
- Gjithësej, numri i çështjeve të Prokurorisë së Apelit për vitin 2023: 16 617 ³³

Sipas të dhënave nga Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit, numri i çështjeve të përfaqësuara në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm nga prokurorët e apelit është **rritur me 25,6%** nga viti 2023 në vitin 2024. Ky shtim i konsiderueshëm i çështjeve sjell jo vetëm nevojën për **plotësimin e vakancave në pozicionet e prokurorëve** të apelit (ashtu si u trajtua më lart), por edhe të **stafit administrativ** mbështetës, si dhe **faciliteteve materiale**.

Konkluzione për vendosjen e standardeve për kohëzgjatjen e procesit gjyqësor dhe ndikimin e hartës së re gjyqësore në efencën e punës së PA

Respektimi i standardeve të kohëzgjatjes së secilës prej hallkave të procedurës gjyqësore janë në përgjegjësi si të Gjykatës së Apelit për t'i zbatuar, ashtu edhe të Prokurorisë të vendosur pranë kësaj gjykate. Problematika më të shpeshta hasen me afatin e ekzekutimit të vendimeve, të cilat karakterizohen nga vonesa. Stadardet lidhur me informimin e publikut për (ndër të tjera) kohëzgjatjen e procesit facilitohen nëpërmjet rubrikës së 'Programit të Transparencës' në faqen zyrtare të Prokurorisë së Apelit, megjithëse informacioni për prokurorin e medias nuk është ende i aksesueshëm në faqe.

Harta e re gjyqësore ka sjellë përqendrimin e prokurorisë së apelit në një institucion të vetëm në Tiranë. Ky ristrukturim ka potencialin të rrisë efikasitetin e punës së Prokurorisë nëpërmjet përcaktimit të standardeve të njëjta të punës, organizimin dhe komunikimin më të lehtë midis prokurorëve. Megjithatë, kjo prokurori ende nuk ka nisur të punojë me kapacitet të plotë, duke qenë se aktualisht 50% i pozicioneve të prokurorëve të apelit janë vakante. Kjo ka sjellë rritje të volumit të punës së prokurorëve aktualë, dhe ka potencial të ngadalësojë procedurat në Gjykatën e Apelit, për shkak të pamundësisë objektive të prokurorëve për të qenë prezent në disa seanca gjyqësore njëkohësisht. Nevoja për shtim të stafit administrativ dhe faciliteteve të përshtatshme për volumin e ri të punës është evidente.

II.6 Trajtimi i vonesave në procedura

II.6.1 A ka Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit një departamenti të ngarkuar me monitorimin e kohëzgjatjes së procedimeve?

Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit nuk ka një departament të veçantë dedikuar monitorimit të kohëzgjatjes së procedimeve. **Prokurori i shortuar** për të përfaqësuar akuzën në GJA mban përgjegjësi për vonesat që mund të shkaktohen nga ana e tij. Drejtuesi i prokurorisë ka kompetencën të mbikëqyrë disiplinën në punë të prokurorëve dhe i bën kërkesë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e inspektimit për shkelje disiplinore të prokurorëve.³⁴

II.6.2 A përdor prokurori njoftimet automatike elektronike për afatet kohore?

³³ Marrë nga Raporti Vjetor mbi ecurinë e punës në Prokurorinë e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për vitin 2023, faqe 3.

³⁴ Ligji Nr. 97/2026 'Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë' (i ndryshuar)

Jo. Njoftimet automatike elektronike ende nuk janë zbatuar, në mungesë të vënies në funksion të sistemit elektronik të menaxhimit të çështjeve.

II.6.3 A ka mekanizma të disponueshëm për palët për t'u ankuar gjatë procesit lidhur me kohëzgjatjen e paarsyeshme të hapave të caktuar procedural në përgjegjësi të prokurorëve?

Rregullorja për Prokurorinë e Gjykatës së Apelit Tiranë parashikon që kërkesat/ankesat e qytetarëve, avokatëve dhe institucioneve janë dokumente hyrëse që vijnë në adresë të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit, të cilat regjistrohen në regjistrin e ankesave.³⁵ **Inspektori i Lartë i Drejtësisë (ILD)** është autoriteti shtetëror përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe për fillimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve.³⁶

Lidhur me vitin 2023, Raporti vjetor i Prokurorisë së Apelit shprehet se nuk ka as dhe një rast që çështja të mos jetë zhvilluar për shkak të mungesës së prokurorit.³⁷ Megjithatë, vetë raporti pranon që, për shkak të numrit shumë të reduktuar të prokurorëve (nëntë të tillë gjatë 2023), çështjet të shtyhen për shkak të pamundësisë objektive të prokurorit për të qenë fizikisht prezent gjatë procesit.³⁸

II.6.4 A mundet prokurori i prokurorisë së apelit të ndërmarrë hapa për të zbutur vonesat aktuale ose për t'i parandaluar në të ardhmen dhe për të përshpejtuar procedurat?

Po, prokurori ose Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit si institucion marrin masa për të evituar vonesat apo zgjatjet e paarsyeshme të procedurave, Raporti vjetor i PA për vitin 2023 rendit:

- Marrjen e masave për t'u paraqitur në çdo seancë gjyqësore, në mënyrë që të mos shkaktohet shtyrja e seancave gjyqësore në Gjykatën e Apelit për shkak të mungesës së prezencës së prokurorit;
- Nxjerrjen në kohë e urdhërave të ekzekutimit në zbatim të vendimeve të Gjykatës së Apelit;
- Dërgimin pa vonesa të vendimeve penale në prokuroritë e rretheve gjyqësore kompetente;
- Ushtrimin brenda afateve ligjore të së drejtës së Rekursit në GJL.³⁹

II.6.5 A është e mundur të vendosen sanksione ndaj palëve/avokatëve/ekspertëve që vonojnë procedurat (p.sh. paralajmërim, zëvendësim, gjoba)?

Përveç prokurorit, edhe palët e tjera kanë përgjegjësi për të mos vonuar procedurat gjyqësore. Për shembull, veprime të mbrojtësit që mund të shkaktojnë vonesa të pajustificuara, si lënia ose refuzimi i ofritit të mbrojtjes, sjell pasoja. Organi procedues i referon **këshillit drejtues të dhomës së avokatëve** rastet e lënies së mbrojtjes, të refuzimit të mbrojtjes dhe të shkeljes nga ana e mbrojtësve të detyrave të besnikërisë dhe ndershmërisë.⁴⁰ Detyrimi i mbrojtësve për të respektuar afatet e procedimit dhe ai i besnikërisë dhe ndershmërisë parashikohen edhe në Kodin e Etikës së Avokatëve.⁴¹

II.6.6 Cilat janë disa aspekte të pavarura nga cilësia e punës së prokurorëve të apelit të cilat ndikojnë në vonesa?

Disa nga problematikat të cilat kanë ndikuar në uljen e shpejtësisë së procedimit të çështjeve të prokurorisë së Apelit lidhen me faktin që gjykata e Apelit dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit nuk ndodhen në të njëjtën godinë, duke shtuar **kohën e transportit dhe pritjes** së prokurorëve. Gjithashtu, referuar edhe Raportit vjetor

³⁵ Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, Neni 12(1)(a).

³⁶ Ligji 115/2026 'Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë', Neni 194.

³⁷ Raporti Vjetor mbi ecurinë e punës në Prokurorinë e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për vitin 2023, faqe 3.

³⁸ Po aty.

³⁹ Raporti Vjetor mbi ecurinë e punës në Prokurorinë e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për vitin 2023, faqe 35.

⁴⁰ KPrP, Neni 56(1)

⁴¹ Kodi i Etikës së Avokatëve, Kapitulli III.

të Prokurorisë së Apelit për vitin 2023, edhe **procedura e fotokopjimit** të dosjeve nga ana e sekretarisë gjithashtu shfaq probleme lidhur me menaxhimin e volumit.⁴²

Sipas Raportit Vjetor të PP 'Mbi ngarkesën e punës së prokurorive', Ngarkesa mesatare për prokurorë faktikë në vitin 2023, rezulton të jetë 372 çështje.⁴³ Kjo është një vlerë ndjeshëm e lartë, e cila ka potencialin të ndikojë negativisht në efikasitetin e punës së Prokurorisë së Apelit. Po ashtu, edhe administrata mbështetëse e kësaj prokurorie është e nevojshme të përshtatet në numër me volumen e ri të punës në këtë prokurori.

Konkluzione për trajtimin e vonesave në procedura

Megjithë shtimin e volumit të punës pas ndryshimit të hartës gjyqësore, raportet konstatojnë se nuk ka mungesa të pajustifikuara nga prokurorët e apelit në seanca gjyqësore. Palët në një proces gjyqësor duhet të tregohen të kujdesshme në respektimin e afateve të proceseve. Ndaj prokurorit që shkel detyrimet e tij për të qenë prezent në procesin gjyqësor, mund të ngrihen ankesa pranë ILD. Po ashtu, edhe mbrojtësit të cilët mund të refuzojnë ose të lenë në mes mbrojtjen duke shkaktuar pengesa dhe rrjedhimisht vonesa në proces, mund të përballen me masa disiplinore të marra nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë. Disa faktorë që ndikojnë në vonesa, pavarësisht se nuk lidhen me punën e vetë prokurorëve, janë mungesa e faciliteteve si distanca fizike mes prokurorisë dhe gjykatës së apelit, nevoja për pajisje me mjete më efikente për menaxhimin e punëve administrative, etj.

II.7 Përdorimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit

II.7.1 A përdor prokuroria një sistem elektronik të menaxhimit të çështjeve?

Aktualisht një sfidë për prokurorinë në përgjithësi është mungesa e një sistemi elektronik të integruar të menaxhimit të çështjeve. Aktualisht, Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit nuk ka një sistem elektronik të aksesueshëm nga prokurorët për të shkurtuar kohën e marrjes së informacionit dhe menaxhimit të çështjeve. Prokuroria e Përgjithshme ka një regjistër elektronik të dedikuar 'PRESTO' për të siguruar që të gjitha rastet e pastrimit të parave të gjurmohen me synimin për të rritur efektivitetin në sekuestrimin dhe konfiskimin e produkteve kriminale. Megjithatë, ky sistem nuk është i aplikueshëm për prokurori të tjera dhe jo në mënyrë shteruese për të gjitha çështjet që trajton PP. Një rekomandim i PP për vitin 2024 ka qenë nevoja për vijimin e punës së nisur dhe të papërfunduar nga Projekti Euralius V për zhvillimin dhe përfundimin e sistemit elektronik PRESTO, për administrimin elektronik të regjistrave proceduralë dhe përfitimin e statistikave me të dhëna në kohë reale dhe gjithëpërfshirëse, të hollësishme dhe të besueshme në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, në këtë periudhë të ndërmjetme/tranzitore, deri në ngritjen dhe funksionimin e sistemit të ri CAMS.⁴⁴

Sipas Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë (SND) 2024-2030, digjitalizimi i sistemit të drejtësisë dhe vënia në funksion e sistemit të integruar të menaxhimit të çështjeve paraqet vështirësi dhe sfida, të cilat duhen adresuar. Vonesat në ndërtimin e sistemit të integruar të menaxhimit të çështjeve paraqesin një risk të konsiderueshëm, në vënien në funksion të këtij sistemi.⁴⁵

Në këtë drejtim, Udhëzimi i Përgjithshëm i Prokurorisë së Përgjithshme Nr. 05 datë 16.05.2024 'Për rekomandimet prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2024 në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm' parashikon se drejtuesit e strukturave në Prokurorinë e Përgjithshme garantojnë marrjen e masave nga strukturat përkatëse, si për *rishikimin e sistemit elektronik* të ndarjes së çështjeve në prokurori, me qëllim arritjen e funksionimit të plotë të tij, ashtu dhe për mbikëqyrjen teknike dhe administrative nëpërmjet kërkesave për informacion lidhur me mënyrën e disponimit për hedhjen e shortit elektronik nëpërmjet sistemit CAMS në të gjitha fazat e procedimit penal, si dhe kontrolli i vazhdueshëm mbi hedhjen

⁴² Raporti Vjetor mbi ecurinë e punës në Prokurorinë e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për vitin 2023, faqe 4.

⁴³ Raporti Vjetor i Prokurorisë së Përgjithshme 'Mbi ngarkesën e punës së prokurorive' (2023), faqe 12.

⁴⁴ Raporti Vjetor i Prokurorisë së Përgjithshme 'Mbi ngarkesën e punës së prokurorive' (2023), faqe 17.

⁴⁵ SND 2024-2030, faqe 22.

dhe administrimin e këtyre të dhënave.⁴⁶ Po ashtu, i njëjti Udhëzim i Përgjithshëm rregullon marrjen e masave për përmirësimin dhe përditësimin e sistemit elektronik e-tracking PRESTO si për vënien në efikasitet sa më të plotë, ashtu dhe për përfundimin e të dhënave statistikore, sipas një baze të të dhënave të qëndrueshme e të besueshme.⁴⁷

Së fundi, përsa i përket digjitalizimit të monitorimit të të dhënave, ky Udhëzim i Përgjithshëm parashikon monitorimin e të dhënave në sistemin elektronik SVOPGJP për oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve në prokurori, për numrin e veprimeve hetimore që kryejnë për secilin procedim penal apo procedim/hetim pasuror, me synim mbikëqyrjen e veprimtarisë së policisë gjyqësore për rritjen e efektivitetit dhe shpejtësisë së hetimeve.⁴⁸ Pikërisht mirëmenaxhimi i këtij sistemi përbën dhe një nga *rekomandimet* e parashikuara nga Raporti vjetor i PP mbi ngarkesën e punës për vitin 2023. Ai parashikon vijimin e punës për përmirësimin e sistemit elektronik (SVOPGJP) dhe vënien e tij në funksionim të plotë për oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve në prokurori dhe për monitorimin periodik të ngarkesës dhe disiplinës në punë gjatë veprimtarisë së tyre në zbatim të udhëzimit të përgjithshëm nr. 10/2021 “Për ushtrimin e funksionit të monitorimit në sistemin e prokurorisë dhe bashkëpunimin me institucionet kushtetuese dhe ligjore”, i ndryshuar, me synim administrimin e punës të secilit oficer të policisë gjyqësore të seksioneve në prokurori dhe për të vijuar lehtësimin dhe mbështetjen e prokurorëve me numër të reduktuar në prokuroritë përkatëse.⁴⁹

II.7.2 A përdor Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit komunikimin elektronik (e-dosje) me gjykatat dhe palët për të shkëmbyer dokumente?

Jo. Pavarësisht përpjekjeve për miratimin e një kornize ndërveprueshmërie për hapjen e një sistemi të integruar të menaxhimit të rasteve, ende nuk ka një sistem të tillë. Informacioni lidhur me çështjet dhe fazat e tyre disponohet edhe në format elektronik nga ana e stafit të Prokurorisë. Megjithatë, nuk bëhet fjalë për sisteme të integruara të të dhënave ku secili prej prokurorëve apo stafi i autorizuar të ketë mundësi të aksesojë informacionin që i duhet në mënyrë të shpejtë dhe automatike.

II.7.3 A përdoren rregullisht raportet statistikore për kohëzgjatjen e procedurave dhe vonesat për menaxhimin e rasteve brenda shërbimit të prokurorisë?

Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit ka zyrën e statistikave, e cila mbledh dhe përpunon të dhëna lidhur me ngarkesën e prokurorëve, kohëzgjatjen e procedurave, llojet e çështjeve të ndjekura në Gjykatën e Apelit, etj. Përveç përdorimit të brendshëm, të dhënat statistikore të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit, së bashku me të dhëna të tjera mbi punën e kësaj prokurorie publikohen në Raportin Vjetor mbi ecurinë e punës në Prokurorinë e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, në të cilin përcaktohen edhe përpjekjet për të ardhmen për përmirësimin e aspekteve të caktuara të punës. Megjithatë, përpunimi i të dhënave nuk është automatik përmes një sistemi, por realizohet kryesisht manualisht nga punonjësit përgjegjës.

II.7.4 A përdoret Inteligjenca Artificiale (AI) nga prokurori/shërbimi i prokurorisë?

Jo. Në mungesë të një sistemi elektronik të menaxhimit të çështjeve, aktualisht nuk ka përdorim të AI.

Konkluzione për përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit

Përdorimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit është i rëndësishëm për procesin e menaxhimit të çështjeve në prokurori. Përdorimi i menaxhimit elektronik të çështjeve ndikon drejtpërdrejt në rritjen e efikasitetit dhe cilësisë së punës, duke lejuar akses të shpejtë në dosje dhe të dhëna; organizimin e të dhënave

⁴⁶ Udhëzimi i Përgjithshëm i Prokurorisë së Përgjithshme Nr. 05 datë 16.05.2024 'Për rekomandimet prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2024 në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm', Neni 4(3)(a).

⁴⁷ Po aty, Neni 4(3)(c).

⁴⁸ Udhëzimi i Përgjithshëm i Prokurorisë së Përgjithshme Nr. 05 datë 16.05.2024 'Për rekomandimet prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2024 në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm', Neni 4(3)(dh).

⁴⁹ Raporti vjetor 'Mbi ngarkesën e punës së prokurorëve (2023)', faqe 16.

të dosjes; përmirësimin e gjurmimit dhe menaxhimit të çështjeve; lehtësimin e komunikimit mes prokurorëve; përpunimin e informacionit për statistika të sakta; eliminimin e mundësisë së gabimeve njerëzore dhe promovimin e konsistencës në trajtimin e çështjeve.

Aktualisht, Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit **nuk përdor** një sistem elektronik të menaxhimit të çështjeve. Sipas SND, digjitalizimi i sistemit të drejtësisë dhe vënia në funksion e sistemit të integruar të menaxhimit të çështjeve paraqet vështirësi dhe sfida, të cilat duhen adresuar. Nevoja për krijimin e një *sistemi elektronik të menaxhimit të çështjeve* është i rëndësishëm të zbatohet dhe të jetë funksional në drejtim të:

- mbajtjes së të dhënave të dosjeve;
- mbajtjes dhe menaxhimit të afateve;
- ndërveprimit me databaza të institucioneve të tjera (për shembull, gjykata, policia gjyqësore, noteria etj.);
- prodhimit të statistikave;
- matjes së volumit të punës; etj.⁵⁰

III. Cilësia në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm

Cilësia në punën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit është parësore për ruajtjen e integritetit të procesit gjyqësor dhe mbrojtjen e të drejtave të individëve. Pas riorganizimit të hartës gjyqësore në Shqipëri, garantimi i një standardi të lartë të cilësisë në gjykimet ligjore dhe vendimet e prokurorisë është jo vetëm thelbësore, por e pritshme nga publiku. Cilësia jo vetëm që përfshin vlerësimin e plotë dhe të drejtë të argumenteve ligjore, por gjithashtu edhe respektimin e standardeve etike dhe praktikave më të mira në sjelljen e prokurorisë. Secili nga nënkapitujt e mëposhtëm përfaqëson nga një element thelbësor që lidhet me cilësinë e punës në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit dhe përfundon me konkluzione specifike mbi aspektet pozitive aktuale dhe nevojat për përmirësim.

III.1 Vlerësimi i prokurorëve nga KLP

III.1.1 Cilat janë kriteret e vlerësimit etik dhe profesional të prokurorëve pranë Gjykatës së Apelit?

Sipas Nenit 149/a (1)(a) të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë Vlerësimi i prokurorëve është një kompetencë kushtetuese e KLP. Posaçërisht, kjo është kompetencë e Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale brenda Këshillit. Qëllimi i këtij vlerësimi është përmirësimi i vazhdueshëm i etikës dhe aftësive profesionale të prokurorit, zhvillimi i karrierës mbi bazën e meritës, identifikimi më mirë i nevojave për kualifikimin e mëtejshëm, si dhe përmirësimi i efikasitetit të zyrave të prokurorisë.⁵¹ Rregullat e vlerësimit etik dhe profesional të prokurorëve përcaktohen në Rregulloren Nr. 95 datë 09.05.2022 'Për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve'. Kjo rregullore është e aplikueshme për të gjithë prokurorët, jo vetëm për ata të apelit, i miratuar me vendim të KLP-së.

Vlerësimi etik dhe profesional i prokurorëve kryhet sipas **disa kriterëve**, si:

- **aftësitë profesionale të prokurorit** (ku përfshihen vlerësime lidhur me njohuritë ligjore dhe arsyetimin ligjor);
- **aftësitë organizative** (ku përfshihet aftësia për të përballuar ngarkesën e punës; si koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje deri në marrjen e vendimit, aktit përfundimtar; rendimenti i përfundimit të

⁵⁰ Bazuar në: Recommendation on the design of information systems (Rec. No R (2001) 2; Recommendation on the delivery of court and other legal services through the use; Recommendation on the interoperability of information systems (Rec. (2003) 14); Recommendation on the archiving of electronic documents (Rec. (2003) 15). of new technologies (Re. No R (2001) 3).

⁵¹ Raporti vjetor i KLP (2023), faqe 53.

çështjeve; aftësia për të kryer procedurat hetimore dhe procedura të tjera të sistemit të prokurorisë; dhe aftësia për të administruar dosjen hetimore ose praktikën përkatëse);

- **etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale të prokurorit** (ku përfshihet etika në punë, integriteti, paanësia, gatishmëria e prokurorit për t'u angazhuar në veprimtari të tjera);
- **aftësitë personale dhe angazhimi profesional.**⁵²

Treguesit dhe standardet për matjen e secilit prej katër kriterëve të mësipërm përcaktohen në Aneksin Nr. 1 'Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të prokurorit', i cili është pjesë e rregullores dhe detajon në mënyrë të hollësishme ndajen e pikëve të vlerësimit të prokurorit në komponentë dhe nënkomponentë. Ky aneks ka për qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të prokurorit, për secilin kriter dhe treguesit përkatës ligjorë, mbi bazën e një sistemi pikësh, të përcaktuar mbi meritat e prokurorit, kualifikimin, integritetin, aftësinë dhe efikasitetin e tij, duke respektuar parimin e pavarësisë së prokurorit. Vlerësimi i prokurorëve bazohet në dosjen personale të prokurorit; të dhënat statistikore, sipas përcaktimeve të parashikuara në nenin 90, të ligjit Nr. 96/2026 'Për statusin e gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë'; dosjet e përzgjedhura me short për vlerësim, sipas nenit 91, të ligjit për statusin, duke përfshirë edhe regjistrimet e seancave me mjete audio ose video; formulari i integruar i vlerësimit të prokurorit dhe aktet e përzgjedhura prej tij; etj.⁵³ Aneksi Nr.2 i Rregullores përcakton modelin e tabelave statistikore me të dhënat për secilin prokuror që do të vlerësohet, si dhe të dhënat mesatare për seksionet apo të gjithë Prokurorinë ku ka ushtruar detyrën prokurori i cili vlerësohet.

Vlerësimi etik dhe profesional i prokurorëve vijon të realizohet nga KLP, megjithë disa **vështirësi që burojnë nga nevoja për ngritjen e sistemit elektronik** të menaxhimit të çështjeve. Në mungesë të këtij sistemi elektronik, duhet që të gjitha të dhënat të nxirren manualisht nga punonjësit e administratës së prokurorisë, çka ngarkon punën e administratës dhe komunikimin burokratik. Gjithashtu, raporti vjetor i KLP për vitin 2023 shpreh shqetësimin që gjatë procesit të vlerësimit janë hasur vështirësi në plotësimin e tabelave sipas anekseve të Rregullores së Vlerësimit nga prokuroritë në të cilat kanë ushtruar funksionin prokurorët e shortuar për vlerësim. Ky ndërç ka sjellë dhe vonesa në kryerjen në afat të këtij procesi.⁵⁴ Në takimet e zhvilluara me Prokurorin e Përgjithshëm është trajtuar problematika e hasur dhe mundësia e bashkëpunimit në plotësimin e regjistrave fizikë statistikore me të dhënat që kërkohen për procesin e vlerësimit etiko-profesional të prokurorëve, si dhe nevojën e krijimit të një sistemi të unifikuar elektronik të të dhënave statistikore.⁵⁵

Gjatë vitit 2023, Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale përfundoi me sukses procedurat e shortit në të gjithë Prokuroritë e Juridiksionit të Përgjithshëm për të gjithë prokurorët si subjekt vlerësimi të shortuar nga Këshilli. Për të garantuar paanësinë dhe vlerësimin etik dhe profesional sa më objektiv, një pjesë e konsiderueshme e hallkave procedurale të këtij procesi **përcaktohen me short**, si përzgjedhja e prokurorëve që vlerësohen në një periudhë të caktuar, përzgjedhja e çështjeve të prokurorit objekt vlerësimi, përcaktimi i relatorit përgjegjës për çdo vlerësim, etj. Megjithatë, duke marrë parasysh nevojën për prokurorë në të gjithë sistemin e prokurorisë, Komisioni vlerësoi që në planifikimin e vlerësimeve individuale të aplikoheshin disa filtrave selektivë ligjorë me qëllim përcaktimin e një liste të arsyeshme të prokurorëve për të cilët mund të realizohet një proces vlerësimi i plotë dhe cilësor përgjatë vitit 2024, duke përjashtuar kategori të caktuara prokurorësh, si anëtarët prokurorë të KLP, prokurorët e komanduar në struktura të tjera, ata në prag pensioni, si dhe Prokurorët e Prokurorisë pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, për shkak të ngarkesës specifike.

⁵² Rregullorja për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve, Neni 7.

⁵³ Rregullorja për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve, Aneksi 1.

⁵⁴ Raporti Vjetor i KLP (2023), faqe 54.

⁵⁵ Po aty.

III.1.2 Sa prej prokurorëve të PA i janë nënshtruar aktualisht vlerësimet etik dhe profesional?

Sipas Raportit vjetor të KLP për vitin 2023, ndër dyzet prokurorët e planifikuar për t'u vlerësuar, një ishte prokuror pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Deri në shkurt 2025, **një prej prokurorëve** të kësaj prokurorie (drejtuesi i prokurorisë) i është nënshtruar vlerësimet etik dhe profesional nga KLP.

Konkluzione lidhur me vlerësimin e prokurorëve nga KLP

Vlerësimi etik dhe profesional i prokurorëve është një hap i rëndësishëm drejt përmirësimit të cilësisë së punës së prokurorisë. Parashikimet e detajuara dhe shumë specifike në pikëzim të Rregullores 'Për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve' dhe tabelat e bashkëlidhura kanë mundësuar një vlerësim objektiv dhe të saktë të tyre. Në këtë drejtim, me rëndësi mbetet nevoja për ngritjen e sistemit elektronik të menaxhimit të çështjeve, çka është e domosdoshme për përsheptimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional të prokurorëve duke zëvendësuar nxjerrjen dhe përpunimin manual të të dhënave, si dhe bashkëpunimi më proaktiv i prokurorëve rrethve dhe apelit.

III.2 Standardet e vendimeve

III.2.1 Çfarë standardesh ekzistojnë për të siguruar që përfaqësimi i akuzës në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit të kryhet në mënyrë të drejtë dhe të paanshme?

Sipas KPrP, në ushtrimin e funksioneve të tij prokurori është **i pavarur**.⁵⁶ Udhëzimi i përgjithshëm i Prokurorisë së Përgjithshme Nr. 12 datë 20.07.2020 'Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë, në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm' parashikon se pavarësia funksionale e prokurorit në vendimmarrje për çështje konkrete duhet të garantohet.

Për të mbrojtur prokurorët nga ndikimet e ndryshme dhe për të siguruar pavarësinë e tyre, ligji 'Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë' garanton pavarësinë dhe autonominë e nevojshme për marrjen e vendimeve gjatë ushtrimit nga prokurorët të funksionit të tyre kushtetues e ligjor, **pavarësisht ndikimit të paligjshëm të brendshëm apo të jashtëm nga çdo autoritet publik a privat**.⁵⁷ Disa nga garancitë që parashikon ligji i mësipërm në drejtim të sigurimit të pavarësisë dhe paanësisë së prokurorëve janë:

- Mbrojtja e prokurorit dhe familjarëve nga kërcënimet (Neni 7 i ligjit);
- Detyrimi për objektivitet dhe barazi në ushtrimin e detyrës (Neni 8 i ligjit).

Në vijim të garancive më sipër, ligji 'Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë' parashikon se magjistrati (në këtë rast prokurori) nuk duhet të krijojë kontakte të papërshtatshme dhe nuk duhet të ndikohet nga pushteti ekzekutiv ose nga pushteti legjislativ. Magjistrati (prokurori) duhet të marrë çdo masë për të qenë dhe të duket se është jashtë çdo ndikimi prej tyre. Ai njofton menjëherë Këshillin dhe Kryetarin, në rast se evidenton ndërhyrje ose ushtrim të ndikimit të papërshtatshëm ndaj tij.⁵⁸ Disa nga garancitë që parashikon ligji i mësipërm në drejtim të sigurimit të pavarësisë dhe paanësisë së prokurorëve janë:

- Nuk mund të jenë anëtarë në parti politike (Neni 6 i ligjit);
- Nuk mund të administrojnë, drejtojnë, apo zotërojnë në mënyrë aktive aksione në shoqëri tregtare (Neni 7(4) i ligjit);

⁵⁶ KPrP, Neni 25(2).

⁵⁷ Ligji Nr. 97/2026 'Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë', Neni 6(3).

⁵⁸ Ligji Nr. 96/2026 'Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë', Neni 3(3).

- Nuk mund të ushtrojnë funksionin në një prokurori, nëse një magjistrat tjetër, me të cilin kanë lidhje të ngushta familjare, ushtron funksionin respektivisht në të njëjtën gjykatë ose prokurori (Neni 8(2)(a) i ligjit);
- Prokurorët dhe familjarët gëzojnë mbrojtje të veçantë gjatë ushtrimit të funksionit ose për shkak të tij (Neni 20 i ligjit);
- Paprekshmëria e pagës dhe përfitimeve të tjera financiare (Neni 22 i ligjit); etj.

III.2.2 A ka detyrime që vendimet e prokurorisë të ndjekin standardet ndërkombëtare?

Sipas ligjit Nr. 97/2026 'Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë', prokurorët në ushtrimin e detyrës u nënshtrohen Kushtetutës, marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe ligjeve të tjera në fuqi.⁵⁹ *Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ)* është një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar e cila është pjesë e kuadrit ligjor shqiptar. Sipas Nenit 17(2) të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, limitimet ndaj të drejtave të njeriut nuk mund të tejkalojnë **parashikimet e KEDNJ**. Kjo dispozitë i rezervon një status të veçantë në hierarkinë e normave të së drejtës në Shqipëri kësaj Konvente. Neni 6 i KEDNJ i cili parashikon të drejtën për një proces të rregullt ligjor, përfshin të drejtën për një procedurë pa vonesa të paarsyeshme dhe të drejtë e në përmbajtje dhe meritë.

Raporti vjetor i Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit për vitin 2023 shprehet se për shkak të krijimit të një gjykate në rang republike, rëndësi në këtë aspekt ka diskutimi i vazhdueshëm mes prokurorëve për të mundësuar qëndrime të njëjta, për çështje të njëjta, aq sa është e mundur pa cënuar pavarësinë e vendimmarrjes së prokurorit, me qëllim dhe një unifikim praktike.⁶⁰ Po ashtu, respektimi i të drejtave të njeriut është evidentuar si prioritet për PA, sidomos në drejtim të afateve të shuarjes së masave të sigurimit për shkak të mbarimit të dënimit, si dhe afateve të gjyqimit të çështjes në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.⁶¹ Ky raport fokusohet më shumë tek të drejtat procedurale (të parashikuara kryesisht nga Neni 6 i KEDNJ), por edhe disa raste që lidhen me dënimet alternative për kategori të caktuara të autorëve, si të miturit, personal vulnerabël, personat me probleme shëndetësore. Megjithatë, ky nënkapitull i raportit nuk detajon informacione lidhur me respektimin e të drejtave të tjera të lidhura ngushtësisht me punën e prokurorisë, si e drejta e mbrojtjes së privatësisë, e drejta e informimit (shpesh vendosja e balancës midis këtyre të dyjave mund të përbëjë sfida për çdo institucion publik), e drejta e prezumimit të pafajësisë, mosdiskriminimi, etj.

E drejta e publikut për informim është një e drejtë kushtetuese, e cila luan një rol të rëndësishëm në garantimin e llogaridhënies dhe transparencës së PA. Shërbimet për marrëdhëniet me publikun në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm kujdesen për informimin e publikut dhe medias në lidhje me veprimtarinë e prokurorisë, si dhe për çështje të veçanta, duke zbatuar kërkesat ligjore për garantimin e sekretit dhe mbarëvajtjes së hetimit.⁶² Për të promovuar sa më sipër, pranë PA është përcaktuar dhe Koordinatori për të Drejtën e Informimit dhe Prokurori i Medias.⁶³ Megjithatë, aktualisht në faqen zyrtare të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit⁶⁴ shfaqet vetëm kontakti i Koordinatorit për të Drejtën e Informimit, ndërsa nuk ka të dhëna lidhur me emrin apo kontaktin e Prokurorit të Medias.

Një nga garancitë e parashikuara nga Neni 6 i KEDNJ është **prezumimi i pafajësisë**. Pavarësisht se detyrimi për respektimin e këtij parimi bie fillimisht mbi gjykatën, prokuroria duhet të bëjë kujdes në mbajtjen e detyrimit të barrës së provës. Barra e provës bie gjithmonë mbi prokurorinë dhe çdo dyshim duhet të jetë në

⁵⁹ Ligji Nr. 97/2026 'Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë', Neni 4(1).

⁶⁰ Raporti Vjetor mbi ecurinë e punës në Prokurorinë e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për vitin 2023, faqe 31.

⁶¹ Po aty

⁶² Ligji Nr. 97/2016 'Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në RSH', Neni 61.

⁶³ Raporti Vjetor mbi ecurinë e punës në Prokurorinë e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për vitin 2023, faqe 36.

⁶⁴ https://www.pp.gov.al/Prokuroria_e_Apelit_Tirane/Media/, aksesuar në shkurt 2025.

favor të të pandehurit. I takon prokurorisë që të informojë të akuzuarin për çështjen që do të ngrihet kundër tij, në mënyrë që ai të përgatisë dhe paraqesë mbrojtjen e tij në përputhje me rrethanat, si dhe të sjellë prova të mjaftueshme për ta kundërshtuar atë.⁶⁵ Raporti i parë vjetor i Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit (pas riorganizimit të hartës gjyqësore) përmban një nënkapitull të shkurtër lidhur me respektimin e disa të drejtave, pa përmendur të drejtën e prezumimit të pafajësisë dhe mënyrën si është adresuar në vendimmarrjen e kësaj prokurorie.

Barazia dhe mosdiskriminimi janë gjithashtu garanci që duhet të ofrohen nga prokuroria, në kuadër të Neni 6 të KEDNJ. Prokurorët duhet të sigurojnë trajtim të barabartë, objektiv dhe pa paragjykim për të gjithë personat, pavarësisht gjinisë, racës, fesë, etnisë, gjuhës, bindjeve politike, fetare a filozofike, identitetit gjinor, orientimit seksual, gjendjes ekonomike, pronës, arsimimit, lindjes, aftësisë së kufizuar, origjinës shoqërore, përkatësisë prindërore ose për arsye të tjera.⁶⁶ Rëndësia e kësaj garancie pasqyrohet edhe në pikët e vlerësimit etik dhe profesional të prokurorëve. Nën rubrikën 'Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale' (në total 100 pikë), imuniteti ndaj çdo ndikimi ose presioni të jashtëm, nderi dhe dinjiteti vlerësohet maksimalisht me 40 pikë, ndërsa mospërdorimi i gjuhës diskriminuese me maksimalisht 10 pikë. Gjithashtu, programi tematik i Shkollës së Magjistraturës për trajnimin vazhdues 2024-2027 i kushton një vëmendje të veçantë kësaj çështjeje, duke shtuar në kurrikul temën e 'Paragjykimit dhe njëanshmërisë' dhe një tjetër mbi 'Paanshmërinë' në procesin gjyqësor.⁶⁷ Megjithë përpjekjet për adresimin e barazisë dhe mosdiskriminimit, vihet re një mungesë raportimesh lidhur me rezultatet e masave të marra në këtë drejtim specifik.

Konkluzione lidhur me standardet e vendimeve të prokurorëve

Kuadri aktual rregullator parashikon garanci konkrete për mbrojtjen e pozitës së prokurorit dhe sigurimin e pavarësisë në ushtrimin e detyrës së tij. Në vendimmarrjen e tyre, prokurorët duhet të jenë të kujdesshëm në garantimin e standardeve ndërkombëtare të drejtësisë penale dhe të drejtave të parashikuara (ndër të tjera) në KEDNJ, sidomos garancitë që rrjedhin nga Neni 6, e drejta për një proces të rregullt ligjor. Përsa i përket prokurorisë, me rendesi të veçantë janë respektimi i të drejtës për informim, prezumimit të pafajësisë, barazia dhe mosdiskriminimi. Respektimit të këtyre të drejtave u është dhënë një rëndësi e veçantë në sistemin e pikëzimit të prokurorëve në vlerësimin e tyre etik-profesional. Megjithatë, raportet aktuale nuk ndalen në të dhëna apo statistika lidhur me këtë aspekt.

III.3 Pranueshmëria e vendimeve

III.3.1 A ka të dhëna lidhur me pranueshmërinë e kërkesave të Prokurorisë së Apelit Pranë Gjykatës së Apelit? Po e çështjeve të dërguara në Gjykatën e Lartë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit?


Kërkesat e PA drejtuar Gjykatës së Apelit mund të jenë të natyrave të ndryshme, materiale ose procedurale. Më poshtë të dhënat e Raportit Vjetor të PA për vitin 2023 lidhur me disa kërkesa të natyrës materiale, janë përmbledhur në formë skematike në grafikë.

Së pari, lidhur me pranueshmërinë e kërkesave të PA pranë Gjykatës së Apelit (GJA) *për rëndimin e pozitës së të pandehurit*, sipas Raportit vjetor të Prokurorisë së Apelit për vitin 2023 vihet re se pjesa më e madhe e kërkesave të PA nuk janë pranuar (110 çështje) (është lënë në fuqi vendimi i shkallës së parë, janë refuzuar, është vendosur për pushimin e çështjes, etj.). Ndërkohë, Gjykata e Apelit ka pranuar kërkesën e PA në 43 çështje.

⁶⁵ ECHR, Guide on Article 6, Right to a fair trial (criminal limb), paragrafi 201.


⁶⁶ Ligji Nr. 97/2016 'Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në RSH', Neni 8.

⁶⁷ <https://www.magjistratura.edu.al/sq/programi-i-trajnimeve>



Burimi i të dhënave: Raporti vjetor i PA për vitin 2023


Lidhur me kërkesat e prokurorëve të apelit drejtuar Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për ndryshim të vendimit të Shkallës së Parë dhe lehtësim të pozitës së të pandehurit, vihet re një trend më pozitiv për PA, ku nga 55 kërkesa të tilla, 49 janë pranuar nga GJA, si më poshtë:



Burimi i të dhënave: Raporti vjetor i PA për vitin 2023

Trendi i pranueshmërisë në këtë rast është shumë i ndryshëm në krahasim me kërkesat për rëndimin e pozitës së të pandehurit, me një përqindje të lartë të kërkesave të pranuar.

Lidhur me kërkesat e prokurorëve të apelit drejtuar Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pushimin e çështjes, vihet re se 50% e kërkesave janë pranuar nga GJA.



Burimi i të dhënave: Raporti vjetor i PA për vitin 2023

Përsa i përket pranueshmërisë së rekurseve të përgatitura nga Prokurorët e PA, Raporti i PA për vitin 2023 shprehet se një pjesë e konsiderueshme e rekurseve të përpiluara nga ana e Prokurorëve të Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, janë gjetur të drejtë nga ana e Gjykatës së Lartë, duke pasqyruar një unifikim praktike vendimarrëse të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.⁶⁸ Megjithatë, ky raport nuk parashtron të dhëna konkrete lidhur me përqindjen e rekurseve të gjetura të drejta nga ana e GJL. Nëse i referohemi raportit të Gjykatës së Lartë për vitin 2023, numri i vendimeve të mospranimit në dhomë këshillimi lidhur me çështjet penale është 1155.⁶⁹ Megjithatë, kjo shifër nuk jep të dhëna të qarta lidhur me nivelin e pranueshmërisë së rekurseve të nisura nga Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit, pasi në këtë shifër të GJL përfshihen të gjitha rekursat, edhe ato të nisura nga palët e tjera në proces.

Konkluzione lidhur me pranueshmërinë e vendimeve

Niveli i pranueshmërisë së çështjeve shpesh shërben si tregues nëse prokuroria i është përmbajtur standardeve dhe procedurave ligjore. Nëse kërkesat e Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit nuk pranohen nga Gjykata e Apelit (apo rekursat nga Gjykata e Lartë), në mënyrë të vazhdueshme, ky mund të jetë një tregues për mangësi në zbatimin e procedurës, trajtimin e provave ose kuptimin e ligjit. Me përjashtim të rasisë së kërkesave të PA për rëndim të pozitës së të pandehurit, kërkesat e tjera analizuar më lart, përfshirë edhe rekursat drejtuar GJL, rezultojnë me një bilanc pozitiv lidhur me pranueshmërinë. Mungesa e të dhënave konkrete për nivelin e pranueshmërisë nga GJL të rekurseve të nisura nga PA, limiton mundësinë e një vlerësimi të saktë në këtë drejtim.

III.4 Zhvillimi profesional i prokurorëve dhe bashkëpunimi

III.4.1 Çfarë mundësisish trajnimi vazhdues dhe zhvillimi profesional janë në dispozicion të prokurorëve të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit?

Ligji Nr. 96/2016 'Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë' parashikon që 'magjistrati ka të drejtë dhe detyrimin të marrë pjesë në programet e formimit vazhdues. Magjistrati ka të drejtë të propozojë tema trajnimi dhe të bashkëpunojë me KLP, me qëllim përmirësimin e programeve të trajnimit.⁷⁰ Shkolla e Magjistraturës, në bashkëpunim me Këshillin e Lartë Gjyqësor, me Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe, sipas rastit, me Avokaturën e Shtetit harton dhe organizon Programin e Formimit Vazhdues për (ndër të tjerë) prokurorët. Shkolla e Magjistraturës publikon në faqen e saj programin e formimit vazhdues të

⁶⁸ Raporti Vjetor mbi ecurinë e punës në Prokurorinë e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për vitin 2023, faqe 36.

⁶⁹ Raporti Vjetor i Performancës i Gjykatës së lartë, 2023, faqe 47.

⁷⁰ Neni 5 i Ligjit Nr. 96/2016 'Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë'.

magjistratëve (aktualisht është në fuqi programi tematik 2024-2027)⁷¹. Programi aktual përmban module dhe tema të mëvetshme trajnimi në disa fusha: e drejtë private; e drejtë publike; çështje të etikës, integritetit, deontologjisë dhe komunikimit; dhe çështje të menaxhimit gjyqësor.

Kurrikulat e trajnimeve vazhduese duhet të synojnë specializimin e prokurorëve. Gjithashtu, trajnimet vazhduese janë të nevojshme edhe **për prokurorë që mbajnë detyra shtesë administrative**, si drejtuesi i prokurorisë, prokurori i medias, etj.

Në përputhje me shembuj nga praktika të mira të shteteve të tjera, trajnimi i prokurorëve duhet të paraprihet nga një **vlerësim paraprak i nevojave individuale për trajnim** nga njësia përgjegjëse (në këtë rast, Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit). Në këtë mënyrë, trajnimi i secilit prokuror ka potencialin të jetë më efektiv dhe planifikimi i trajnimeve realizohet mbi baza nevojash aktuale.⁷²

III.4.2 Si bashkëpunon Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit me institucionet e tjera?

Në përputhje me Ligjin Nr. 97/2026 'Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë', disa nga organet me të cilat prokuroria ka marrëdhënie të vazhdueshme janë: Këshilli i Ministrave⁷³; Kuvendi⁷⁴; KLP⁷⁵; ILD⁷⁶; Ministrinë e Drejtësisë⁷⁷.

Sipas raportit të PA për vitin 2023, kjo prokurori ka vijuar bashkëpunimin me institucione të tjera, duke përmendur në veçanti ato institucione me të cilat bashkëpunimi i shpeshtë është esencial për realizimin me sukses të detyrave, si:

- Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm;
- Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore;
- Strukturat e Policisë së Shtetit dhe institucionet e tjera që përfshijnë shërbime të Policisë Gjyqësore;
- Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale;
- Prokuroria e Përgjithshme.⁷⁸

III.4.3 Si bashkëpunon Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit me aktorë të ndryshëm ndërkombëtarë?

Sipas Udhëzimit të Përgjithshëm të Prokurorisë së Përgjithshme Nr. 05 datë 16.05.2024 'Për rekomandimet prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2024 në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm', drejtuesit e strukturave në Prokurorinë e Përgjithshme garantojnë (ndër të tjera) vijimin e bashkëpunimit nga struktura përkatëse me agjencitë ligjzbatuese rajonale dhe ndërkombëtare në funksion të efektivitetit të hetimeve për veprat penale prioritare të rekomanduara, veçanërisht ato që lidhen me korrupsionin, trafikimin e narkotikëve, pastrimit të parave, trafikimin e qenieve njerëzore, veprat penale kundër mjedisit, krimet kibernetike, përmirësimin e koordinimit institucional dhe ndërinstitutional me institucionet dhe agjencitë e tjera në lidhje me raportimet në zbatim të rekomandimeve të BE-së në kuadrin e integritetit evropian të vendit; etj.⁷⁹

Në kuadër të përmirësimit të mëtejshëm dhe eficient në bashkëpunimin dhe koordinimin institucional dhe marrëdhëniet juridiksionale me Zyrën e Prokurorit Ndërlidhës në Eurojust, në vitin 2023 është vendosur theksi tek komunikimit i vendimeve të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për të tilla raste, në kohë

⁷¹ <https://www.magjistratura.edu.al/sq/programi-i-trajnimeve>, aksesuar në shkurt 2025.

⁷² Shiko, për shembull: OECD, Performance of the Prosecution Services in Latvia, a comparative study, 2021, faqe 103.

⁷³ Neni 103 i Ligjit Nr. 97/2026 'Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë'.

⁷⁴ Ibid. Neni 104.

⁷⁵ Ibid. Neni 105.

⁷⁶ Ibid. Neni 106.

⁷⁷ Ibid. Neni 107.

⁷⁸ Raporti Vjetor mbi ecurinë e punës në Prokurorinë e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për vitin 2023, faqe 36.

⁷⁹ Udhëzimi i Përgjithshëm i Prokurorisë së Përgjithshme Nr. 05 datë 16.05.2024 'Për rekomandimet prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2024 në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm', Neni 4(3)(b) dhe (ç).

autoriteteve përkatëse, si dhe rritja e bashkëpunimit me Prokurorin Ndërlidhës në Eurojust me qëllim administrimin në kohë të akteve të kërkuara dhe përfundimit të suksesshëm të këtyre çështjeve.⁸⁰ Bashkëpunimi me Zyrën e Prokurorit Publik European (EPPO) është konsoliduar.

Konkluzione lidhur me zhvillimin profesional të prokurorëve dhe bashkëpunimin

Prokurorët kanë të drejtën dhe detyrimin të marrin pjesë në programet e formimit vazhdues, në përputhje me parashikimet e ligjit 'Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë'. Po ashtu, në vijim të këtij detyrimi, Udhëzimi i Përgjithshëm i Prokurorisë së Përgjithshme Nr. 05 datë 16.05.2024 'Për rekomandimet prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2024 në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm' parashikon që prokurorët marrin masa për rritjen dhe zhvillimin e kapaciteteve dhe aftësi profesionale, nëpërmjet pjesëmarrjes në trajnime apo në tryeza diskutimesh, si dhe trajnime të përbashkëta me oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve dhe të strukturave hetimore në shërbimet.⁸¹ Gama e gjerë të trajnimeve të mundshme për të ndjekur është një tregues pozitiv për mundësitë reale të prokurorëve lidhur me zhvillimin e karrierës dhe përditësimin e informacionit. Megjithatë, një theks i veçantë duhet t'i kushtohet trajnimit të vazhdueshëm të drejtuesve të prokurorive, zëvendës drejtuesve të prokurorive apo prokurorëve të medias për detyrat e tyre të shtuara administrative, si dhe mirëplanifikimit të trajnimit vazhdues, nëpërmjet vlerësimit të nevojave të prokurorisë.

Bashkëpunimi me institucionet e tjera të drejtësisë duhet të vazhdojë të përforcohet, duke eliminuar burokracinë dhe zvarritjet e procedurave nga të gjitha palët. Nevoja për bashkëpunim edhe në nivel ndarje të të dhënave dhe databazave elektronike, në përputhje me legjislacionin në fuqi është me rëndësi prioritare.

IV. Përmbledhje Konkluzionesh dhe Rekomandime

Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit është një nga organet e drejtësisë që kaloi nëpër ndryshimet më të mëdha (së bashku me Gjykatën e Apelit) pas miratimit të hartës së re gjyqësore. Diskutimi i standardeve të efikasitetit dhe cilësisë së një institucioni të rikonceptuar prej vetëm dy vitesh nxjerr ne pah përpjekjet serioze për kapërcimin me sukses të periudhës së tranzicionit, por edhe një sërë elementësh që kanë nevojë për përmirësim. Janë bërë përpjekje serioze për menaxhimin e numrit të shtuar të çështjeve, pavarësisht numrit të kufizuar të prokurorëve, për miratimin e kuadrit rregullator të ri, (pjesërisht) kategorizimin e çështjeve, vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve, zhvillimin e tyre profesional vazhdues, etj.

Ky raport ka evidentuar disa aspekte që kanë nevojë për përmirësim të mëtejshëm, të cilat mund të grupohen në **pesë** drejtime kryesore:

Së pari, nevoja për shtim të burimeve njerëzore, duke përfshirë plotësimin e vakancave të prokurorëve, por edhe personelin administrativ të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit. Aktualisht kjo prokurori po funksionon me 50% të numrit të prokurorëve të miratuar në organigramë, ndërkohë KLP ka hapur 3 vakanca për pozicione të përhershme në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit. Volumi i çështjeve të përfaqësuara nga kjo prokurori pranë Gjykatës së Apelit është rritur me 25,6% në vitin 2024, krahasuar me 2023. Kjo rritje e volumit të punës së prokurorëve ka sjellë si pasojë edhe rritjen e punës së stafit administrativ të prokurorisë dhe ka nxjerrë në pah nevojën për shtimin e këtij stafi. Mungesa e burimeve të mjaftueshme njerëzore karakterizon jo vetëm prokurorinë, por edhe GJA. Vonesat në zbardhjen e vendimeve të arsyetuara të GJA për shkak të mbingarkesës së punës ndikojnë edhe në shpejtësinë e punës në prokurorinë pranë kësaj gjykate.

Së dyti, nevoja për shtim të faciliteteve për mirëmenaxhimin e punës në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit. Për shembull, vlerësohet i nevojshëm *caktimi i një numri unik të çështjes/dosjes* në momentin që nis procedimi penal në Prokurorinë e Shkallës së Parë, dhe mosndryshimi i këtij numri në Prokurorinë e Apelit

⁸⁰ Raporti Vjetor mbi ecurinë e punës në Prokurorinë e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për vitin 2023, faqe 32.

⁸¹ Udhëzimi i Përgjithshëm i Prokurorisë së Përgjithshme Nr. 05 datë 16.05.2024 'Për rekomandimet prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2024 në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm', Neni 8(1)(gj).

dhe gjykata. Një numër unik lehtëson identifikimin e shpejtë të çështjes duke kursyer kohë, redukton gabimet dhe lehtëson komunikimin ndërmjet subjekteve të ndryshme të përfshira në ndjekjen penale dhe gjykimin e një çështjeje. Po ashtu, një mekanizëm i vlerësuar si i suksesshëm në menaxhimin efektiv të volumit të punës në sistemin e drejtësisë është *kategorizimi i çështjeve* brenda juridiksionit të një prokurorie. Pavarësisht disa përpjekjeve për kategorizim dhe shpërndarje të balancuar të çështjeve midis prokurorëve të apelit, ende nuk ka rregullime të detajuara. Lidhur me këtë problem, rekomandohet përdorimi i praktikës së *'case weighting'* apo *'peshimit të çështjeve'*, e cila bazohet në indikatorë dhe një sistem pikëzimi për çdo çështje. Case weighting mund të bëhet i mundur vetëm përmes miratimit të një akti të brendshëm dhe të posaçëm, ku rregullohet në mënyrë shteruese vlerësimi i kompleksitetit të çështjeve dhe shpërndarja e tyre midis prokurorëve bazuar në një sistem pikëzimi. Në këtë kuadër, vlerësohet i nevojshëm edhe pasurimi i burimeve materiale të Prokurorisë pranë Gjykatave të Apelit, me mjete fotokopjimi, skanimi dhe facilitete të tjera për reduktimin e vonesave në proceset mekanike të punës.

Se treti, nevoja për digjitalizimin e menaxhimit të çështjeve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit dhe në gjithë sistemin e drejtësisë. Në kushtet e rritjes dhe përqendrimit të volumit të punës dhe zhvillimit të teknologjisë, automatizimi i një pjese të proceseve të punës në prokurori është shumë i nevojshëm për të rritur *eficencën dhe cilësinë e punës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit nëpërmjet shpejtësisë, saktësisë dhe standardizimit* të proceseve të punës. Digjitalizimi i menaxhimit të çështjeve është thelbësor për përpunimin e të dhënave dhe *gjenerimin e statistikave*. Gjithashtu, ngritja e sistemit të menaxhimit elektronik të çështjeve është i domosdoshëm në drejtim të përshtetimit të *vlerësimit etik dhe profesional* të prokurorëve nga KLP, i cili ka hasur në vështirësi për shkak të mbledhjes manuale të të dhënave nga ana e prokurorëve. Po ashtu, pas ngritjes së sistemit të menaxhimit elektronik të çështjeve, me rëndësi mbetet bashkëpunimi i institucioneve të drejtësisë për të ndarë informacione nga databazat respektive, në përputhje me limitimet e parashikuara me ligj.

Së katërti, nevoja për kurrikula të targetuara të trajnimit vazhdues së prokurorëve, me programe specifike dhe praktike për ushtimin e detyrës së prokurorit. Trajnimi vazhdues i magjistratëve është pasuruar dhe përditësuar. Në këtë drejtim, është i nevojshëm trajnimi i posaçëm dhe periodik specifik për prokurorët, si edhe për ata prokurorë që, krahas detyrës së zakonshme, ushtrojnë edhe detyra administrative, si drejtues prokurorie, zëvendësdrejtues prokurorie, prokuror i medias, etj.

Së fundi, nevoja për një vëmendje të shtuar në aplikimin dhe citimin e standardeve ndërkombëtare (procedurale dhe substanciale) në vendimmarrjen e prokurorëve dhe raportimet e Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit lidhur me to. Sidomos parimet e lidhura me të drejtën e informimit, prezumimin e pafajësisë, barazinë dhe mbrojtjen nga diskriminimi, dhe aspekte të tjera të lidhura me zbatimin e Nenit 6 të KEDNJ, duhet të jenë prioritate në punën dhe raportimet e prokurorisë.

Burimet

Ligje dhe akte normative me fuqi nënligjore

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
- Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë
- Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë
- Ligji 115/2016 'Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë'
- Ligji Nr. 96/2016 'Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë'
- Ligji 97/2026 'Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë'.
- Ligji Nr. 79/2020 'Për ekzekutimin e vendimeve penale'
- Ligji Nr. 25/2019 'Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore'

- Rregullorja 'Per organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë' datë 26.04.2021
- Rregullorja e PP 'Për mbrojtjen e të dhënave personale në shkëmbimin e informacionit me Eurojust'
- Rregullorja e PP Nr. 01 datë 09.07.2020 'Për menaxhimin e aktiviteteve në Prokurorinë e Përgjithshme dhe njësitë e varësisë'
- Rregullorja e KLP Nr. 95 datë 09.05.2022 'Për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve'
- Udhëzimi i PP Nr. 10, datë 30.12.2021 'Për ushtrimin e funksionit të monitorimit në sistemin e prokurorisë dhe bashkëpunimin me institucionet kushtetuese dhe ligjore'
- Udhëzimi i PP Nr. 09 datë 21.12.2021 'Për marrëveshjen mbi kushtet për pranimin e fajësisë dhe për caktimin e dënimit'
- Udhëzim i PP Nr. 01 datë 26.01.2023 'Për masat administrative dhe procedurale për zbatimin e hartës së re gjyqësore në prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm'
- Udhëzimi i PP Nr. 08 datë 04.12.2019 'Për garantimin e pavarësisë së prokurorit, marrëdhëniet ndërmjet tij dhe drejtuesit të prokurorisë dhe informimin në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm'
- Udhëzimi i PP Nr. 05 date 30.07.2019 'Për marrëdhëniet me publikun në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm'
- Udhëzimi i PP Nr. 12 datë 20.07.2020 'Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë, në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm'
- Udhëzimi i PP Nr. 05 datë 16.05.2024 'Për rekomandimet prioritare në luftën kundër kriminatiletit për prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm'
- Kodi i Etikës së Avokatëve

Dokumente politikash dhe raportime nga organet relevante

- Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë 2024-2030
- Raporti Vjetor i KLP (2023)
- Raporti Vjetor i Prokurorisë së Përgjithshme 'Mbi ngarkesën e punës së prokurorëve' (2023)
- Raporti Vjetor mbi ecurinë e punës në Prokurorinë e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm (2023)
- Raporti Vjetor i Performancës së Gjykatës së Lartë (2023)

Artikuj dhe manuale

- Council of Europe, CEPEJ, Case weighting in European Justice Systems, 2018, https://rm.coe.int/cepej-saturn-2017-7erev10e-case-weighting/16808ccb22#_Toc510802389
- ECHR, Guide on Article 6, Right to a fair trial (criminal limb)
- OECD, Performance of the Prosecution Services in Latvia, a comparative study, 2021,

Faqe interneti

- https://www.pp.gov.al/Prokuroria_e_Apelit_Tirane/Programi_i_Transparences_17056
- <https://www.magjistratura.edu.al/sq/programi-i-trajnimeve>